



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

**RAPORT MBI AKTIVITETIN E KRYER NGA QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
GJATË PERIUDHËS KOHORE JANAR – DHJETOR 2022**

Tabela e Përmbajtjes

Faqe

1. Hyrje.....	3
2. Veprimtaria e kryer nga QKB gjatë periudhës kohore Janar– Dhjetor 2022.....	3
3. Projektet e përfunduara gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2022.....	8
4. Baza ligjore që pritet të miratohet në periudhën në vijim.....	10
5. Projektet në process.....	10
6. Analiza e realizimit të treguesve ekonomiko-financiar.....	11
7. Proceset gjyqësore.....	13

1. Hyrje

Qendra Kombëtare e Biznesit është institucion i administratës shtetërore me personalitet juridik në varësi të ministrit të finanacave dhe ekonomisë. Ky institucion ndër të tjera mban regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit; kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit; publikon të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to; trajton procedurat e licencimit, të autorizimit apo të lejeve, të ndryshimit dhe revokimit të tyre, sipas ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet; mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet; siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet; informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit.

Qendra Kombëtare e Biznesit i ushtron funksionet e saj bazuar në Ligjin Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 10081, datë 23/02/2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarit Përfitues”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Bazuar në pikën 2, të nenit 13, të Ligjit Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe pikës 3, të nenit 17, të VKM Nr. 179, datë 9.3.2016, “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Biznesit”, në vijim është raportimi i Qendrës Kombëtare të Biznesit mbi punën e kryer gjatë vitit 2021.

2. Veprimtaria e kryer nga QKB gjatë periudhës kohore Janar– Dhjetor 2022

Qendra Kombëtare e Biznesit gjatë vitit 2022 ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e regjistrimit, licencimit/lejimit/autorizimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të institucionit për vitin 2022 në fokus të punës së strukturave përgjegjëse të Qendrës Kombëtare të Biznesit ka qenë ofrimi i të gjithë shërbimeve vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar e-albania.

Kështu, prej 01 Maj 2022, të gjitha shërbimet e Qendrës Kombëtare të Biznesit ofrohen vetëm elektronikisht nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, dhe sportelet fizike të shërbimit të QKB-së janë mbyllur. Ofrimi i shërbimeve tërësisht online ka angazhuar të gjithë punonjësit e institucionit në dhënien e asistencës për përfaqësuesit e subjekteve në kryerjen e aplikimeve me sukses

ndërkohë që, ndryshime strukturore, me qëllim asistimin e subjekteve që përdorin shërbimet e QKB-së, janë miratuar.

2.1 Mbi përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga QKB-ja

Në bashkëpunim me AKSHI-n dhe kompaninë zhvilluese ka filluar puna për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nëpërmjet portalit qeveritar e-albania në Regjistrin Tregtar, Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve dhe Regjistrin të Pronarëve Përfitues.

Ky proces ndiqet nga një grup pune i përbërë nga punonjës të secilës strukturë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve, të cilët organizojnë testime të aplikimeve online, duke identifikuar problematikat e hasura gjatë zhvillimit të tyre.

Këto problematika përcillen për zgjidhje në aspektin teknik nga kompania zhvilluese ndërkohë që, strukturat përkatëse të institucionit shqyrtojnë aspektet ligjore të këtij procesi.

Në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve QKB-ja ka zhvilluar takime me përfaqësues të subjekteve, ku është diskutuar mbi format e aplikimeve, problematikat e hasura nga subjektet gjatë plotësimit të tyre dhe mbi zgjidhjen e tyre, me qëllim lehtësimin e procedurave të regjistrimit dhe licencimit/leximit/autorizimit të biznesit dhe regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues.

2.2 Mbi aplikimet e trajtuara nga strukturat përgjegjëse

Janë trajtuar në total 280,607 aplikime në të tre regjistrat e administruar nga QKB, nga të cilat:

- **248,294** aplikime në Regjistrin Tregtar
- **7,708** aplikime në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve
- **24,605** aplikime në Regjistrin e Pronarëve Përfitues

Gjithashtu, nga **256,002** aplikime në të tre regjistrat e administruar nga QKB,

- **139,196** aplikime janë paraqitur në sportelet e shërbimit të QKB, para datës 01.05.2022
- **116,806** aplikime janë paraqitur në portalin qeveritar e-Albania, pas datës 01.05.2022

1.3 Mbi kuadrin ligjor në fushën e regjistrimit, licencimit/lejimit/autorizimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues

✓ Ndryshimet ligjore të miratuara

Gjatë vitit 2022 janë rishikuar dhe kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore në fushën e regjistrimit, licencimit/lejimit/autorizimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues si më poshtë:

- Regjistrimi i Biznesit

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të International Co-operation Review Group (ICRG)'s Financial Action Task Force (FATF) gjohet për mospërbushjen e afateve ligjore të detyrimit ligjor për kryerjen e regjistrimeve përkatëse në regjistrin tregtar dhe mosdeklarimeve reale janë konsideruar të ulëta dhe në raport të zhdrejtë me treguesin e paritetit të fuqisë blerëse të vendit. Për këtë arsye gjatë vitit 2022 janë miratuar ndryshimet e mëposhtme:

Hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore në Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, të cilat kanë konsistuar në rritjen e vlerës së gjobës së vendosur për kundravajtjet administrative të lidhura me deklarimin në regjistër të të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale dhe moskryerjes së detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ligji nr. 9723/2007.

➤ Lejimi/Licencimi/Autorizimi i biznesit

Me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve në legjislacionin sectorial gjatë vitit 2022 janë miratuar ndryshimet përkatëse në legjislacionin në fuqi në fushën e licencimit/lejimit/autorizimit si më poshtë:

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i ndryshimeve ligjore në Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me qëllim shtimin e kategorisë së re të licencave, përkatësisht "Prodhimi dhe/ose tregtimi i pajisjeve mjekësore" dhe fushës XIV "Teknologji financiare (Fintech) dhe TIK".

Zbatimi i projektvendimit për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 538 datë 26/05/2009 "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve ligjore sektoriale në fushën e licencimit, të tilla si:

- shtimi i kategorisë së re "Prodhimi dhe/ose tregtimi i pajisjeve mjekësore" me kodin II.9;
- shtimi i fushës XIV "Teknologji financiare (Fintech) dhe TIK";
- përfshirja e spitalit ditor në kategorinë "Shërbime spitalore" me kodin II.6.B;
- eliminimi i disa licencave që trajtohen nga / ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

➤ Regjistrimi i Pronarëve Përfitues

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të International Co-operation Review Group (ICRG)'s Financial Action Task Force (FATF), ku konkretisht citohet se, *"Shqipëria duhet të sigurojë një kuadër ligjor të përshtatshëm për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për entitetet ligjore dhe OJF-të dhe të zbatojë sanksione më proporcionale dhe bindëse, të cilat marrin parasysh treguesin e paritetit të fuqisë blerëse"*, si dhe me qëllim mbështetjen e biznesit në realizimin e detyrimit për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues, u rishikuar Legjislacioni në fuqi si më poshtë:

Hyrja në fuqi i ndryshimeve ligjore në Ligjin Nr. 112/2020, "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", i ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohet:

- popullimi automatik të regjistrimit të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese ekzistuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte;
- shtyrja e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese me pronësi indirekte të regjistruara në regjistrin tregtar dhe nga Organizatat Jofitimprurëse, deri më datë 01/4/2022;j
- aplikimi i njëkohshëm për regjistrimin e pronarëve përfitues nga të gjitha subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi në regjistrin tregtar, në momentin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik;
- falja e gjobave të vendosura nga QKB-ja përpara hyrjes në fuqi të projektligjit, në lidhje me mospërbushjen e detyrimit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues apo për ndryshimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues nga subjektet raportuese, pa i çliruar nga detyrimi që raportimi të kryhet prej tyre deri më 01/4/2022;
- përshkallëzimi i masës së kundërvajtjeve administrative që do të vendosen në vijim të hyrjes në fuqi të projektligjit, mbi bazën e vonesës në përbushjen e detyrimit të raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi;
- parashikimi i procedurës së pezullimit të aplikimit për një afat 30-ditor, në rast të aplikimeve të paplota

✓ **Baza ligjore për rishikim/ndryshim**

Qendra Kombëtare e Biznesit vlerëson se, me qëllim përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e licencimit/lejimit/autorizimit dhe regjistrimit të biznesit, duke marrë në konsideratë problematikat e hasura në praktikë nga subjektet dhe ofrimin e shërbimeve vetëm online nëpërmjet e-albania prej datës 1 Maj 2022, duhen rishikuar legjislacionet e mëposhtme:

Ligji Nr.10081, datë 23/02/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar";

VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar";

Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar";

VKM Nr. 391, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar".

2.3 Mbi trajtimin e kërkesave të subjekteve tregtare dhe institucioneve të tjera

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022 raportohen të dhënat mbi trajtimin e kërkesave të subjekteve tregtare në kanale të ndryshme komunikimi si më poshtë:

Janë trajtuar në total 256,002 aplikime në sportelin fizik dhe në sportelin elektronik (aplikime për shërbime të regjistrimit dhe licencimit të biznesit, aplikime për shërbime në regjistrin e pronarëve përfitues dhe aplikime për depozitimin e pasqyrave financiare), nga të cilat:

- 139,196 aplikime në sportelet e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve;
- 116,806 aplikime janë transaksione për shërbimet online, nga të cilat;
- 23,388 aplikime për bilance të depozituara online;
- 25,089 aplikime të pronarëve përfitues.

Për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2022 janë dhënë në total 230,325 aplikime për shërbime të nivelit 4, konkretisht:

- 110,811 aplikime për Certifikatë Regjistrimi;
- 9,267 aplikime për Lëshim i titullit të licencës/lejes;
- 66,832 aplikime për Ekstrakt i thjeshtë/historik (Biznes);
- 14,692 aplikime për Ekstrakt i thjeshtë/historik (Qytetar);
- 28,723 aplikime për Ekstrakt për të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

Janë procesuar 139,196 aplikime nga sportelet e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve, nga të cilat:

- 137,793 aplikime në Regjistrin Tregtar;
- 1,403 aplikime në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Nga 1 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022, janë regjistruar 17,941 subjekte të reja.

Janë asistuar nëpërmjet email-it dhe telefonatave të gjithë subjektet cilët kanë kontaktuar QKB për të zgjidhur problemet e hasura gjatë aplikimeve me të dhënat si më poshtë:

- Nga 1 Janari 2022 deri më 30 Qershor 2022 janë trajtuar rreth 41,357 email-e dhe janë asistuar 26,577 subjekte në zyrën e asistencës si dhe nëpërmjet telefonit.
- Nga 1 Korriku 2022 deri në 31 Dhjetor 2022 janë trajtuar rreth 36,967 email-e (në ndryshim nga raportimi në 6 mujorin e parë numri 10,485 është numri i email hyrës, ku çdo email për shkak të specifikave të reja të trajtimit të aplikimeve përpunohet minimalisht 3 deri në 4 herë pra rreth 36,967 email-e).

- dhe janë regjistruar 16,874 telefonata për asistim të problematikave të hasura apo sqarime të ndryshme.

Janë trajtuar brenda afateve ligjore të gjithë shkresat e paraqitura nga subjektet për pajisjen me kopje të njejtë me origjinalin të dosjes elektronike

- Nga 1 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 janë trajtuar 496 kërkesa.

Janë trajtuar brenda afateve të gjithë korrespondenca me drejtoritë rajonale tatimore në lidhje me dërgimin e certifikatave të çregjistrimit të subjekteve.

- Nga 1 Janari 2022 deri në 31 Dhjetor 2022 janë dërguar 4,123 certifikata çregjistrimi.

Bashkëlidhur gjeni një tabel me të dhënat e mësipërme:

		Aplikimet Janar - Dhjetor 2022					
Nr	Shërbimi	Total Sportel	Total Online	TOTALI	RT	RKLLA	RPP
1	Regjistrim person fizik	25217	24531	49748	49748		
2	Regjistrim shoqëri kolektive	-	2	2	2		
3	Regjistrim shoqëri komandite	9	10	19	19		
4	Regjistrim Shoqeri me Përgjegjesi te Kufizuar	11528	10002	21530	21530		
5	Regjistrim Shoqëri e Thjeshtë	57	54	111	111		
6	Regjistrim Shoqëri Aksionare	105	110	215	215		
7	Regjistrim Shoqëri Kursim Krediti	1	2	3	3		
8	Regjistrim Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor	34	18	52	52		
9	Regjistrim Degë e Shoqërise së Huaj	112	30	142	142		
10	Regjistrim Zyre Përfaqësimi e Shoqerisë së Huaj	30	32	62	62		
11	Regjistrim Shoqëri e Bashkëpunimit Reciprok	1	-	1	1		
12	Regjistrim fillestar për efekt të ndarjes për Shoqeri me Përgjegjësi të Kufizuar	2	-	2	2		
13	Regjistrimi me kërkesë të çdo të treti të vendimeve të autoritetit	8938	3088	12026	12026		

14	Aktivizim i Aktivitetit të Pezulluar	6563	6491	13054	13054		
15	Çregjistrim Person Fizik	9911	8	9919	9919		
16	Çregjistrim Person Juridik	360	3	363	363		
17	Ndryshim Person Fizik	24604	24258	48862	48862		
18	Ndryshim Shoqëri Kolektive	10	9	19	19		
19	Ndryshim Shoqëri Komandite	12	2	14	14		
20	Ndryshim Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar	26010	766	26776	26776		
21	Ndryshim Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar për efekt të ndarjes	3	-	3	3		
22	Ndryshim Shoqëri Kursim Kredit	29	1	30	30		
23	Ndryshim Shoqëri të Thjeshta	43	-	43	43		
24	Ndryshim Shoqëri Aksionare	1913	11	1924	1924		
25	Ndryshim Dege e Shoqërisë së Huaj	673	-	673	673		
26	Ndryshim Zyre Perfaqësimi e Shoqërisë së Huaj	81	-	81	81		
27	Ndryshim Shoqëri e Bashkëpunimit Reciprok	3	1	4	4		
28	Ndryshim Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor	32	1	33	33		
29	Korrigjim Person Fizik	111	-	111	111		
30	Korrigjim Shoqëri Anonime	111	-	111	111		
31	Korrigjim Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor	2	-	2	2		
32	Korrigjim Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	468	-	468	468		
33	Korrigjim Shoqëri Komandite	-	-	0	-		
34	Korrigjim Shoqëri e Thjeshtë	3	-	3	3		
35	Korrigjim Shoqëri Kursim Kredit	5	-	5	5		
36	Korrigjim Zyre Perfaqësimi e Shoqërisë së Huaj	12	-	12	12		
37	Korrigjim Dege e Shoqërisë së Huaj	13	-	13	13		
38	Fillim Procedurës së Likuidimit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	377	-	377	377		

39	Fillim Procedurës së Likuidimit Shoqëri Anonime	-	-	0	-		
40	Fillim Procedurës së Likuidimit Shoqëri Komandite	-	-	0	-		
41	Fillim Procedurës së Likuidimit Shoqëri e Thjeshtë	-	-	0	-		
42	Fillim Procedurës së Likuidimit Shoqëri Kursim Kredit	-	-	0	-		
43	Fillim Procedurës së Likuidimit Zyre Përfaqësimi	-	-	0	-		
44	Fillim Procedurës së Likuidimit Degë e Shoqërisë së Huaj	-	-	0	-		
45	Fillim i procedurës se likuidimit për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor	32	32	64	64		
46	Miratimi i Bashkimit me Përthithje për Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	23	-	23	23		
47	Miratimi i Bashkimit me Përthithje për Shoqëri Aksionare	4	-	4	4		
48	Miratimi i Ndarjes Në Shoqëri Ekzistuese	-	-	0	-		
49	Miratimi i Ndarjes Në Shoqëri Ekzistuese për Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	1	-	1	1		
50	Miratimi i ndarjes në shoqëri të re për Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	2	-	2	2		
51	Aplikim nga shoqëria përthithëse për njoftimin e miratimit të bashkimit ndërkufitar me përthithje Sipas Nenit 3(1)(a) të Ligjit Nr. 110/2012 (shoqëria që rezultojn nga bashkimi është shoqëri shqiptare)	6	6	12	12		
52	Aplikim nga shoqëria përthithëse për njoftimin e miratimit të bashkimit ndërkufitar me përthithje Sipas Nenit 3(1)(c) të Ligjit Nr.	6	5	11	11		

	110/2012 (shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare)						
53	Aplikim nga shoqëria përthithëse për publikimet e lidhura me bashkimin ndërkufitar me përthithje Sipas Nenit 3(1)(c) të Ligjit Nr. 110/2012 (shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare)	1	-	1	1		
54	Aplikim nga noteri i autorizuar për realizimin e bashkimit ndërkufitar me përthithje Sipas Nenit 3(1)(a) të Ligjit Nr. 110/2012 (shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar)	1	-	1	1		
55	Aplikim nga shoqëria objekt për njoftimin e miratimit të bashkimit ndërkufitar me krijimin e shoqërisë së re Sipas Nenit 3(1)(b) të Ligjit Nr. 110/2012 (shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare)	1	-	1	1		
56	Aplikim nga shoqëria objekt për publikimet e lidhura me bashkimin ndërkufitar me krijimin e shoqërisë së re Sipas Nenit 3(1)(b) të Ligjit Nr. 110/2012 (shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare)	2	-	2	2		
57	Aplikim nga shoqëria objekt për publikimet e lidhura me bashkimin ndërkufitar me përthithje Sipas Nenit 3(1)(c) të Ligjit Nr. 110/2012 (shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare)	1	-	1	1		

58	Publikimet për bashkimin ndërkufitar me përthithje	2	-	2	2		
59	Pezullim Aktiviteti	17718	17549	35267	35267		
60	Shpallja I për Shndërrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	8	2	10	10		
61	Shpallja II për Shndërrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	5	3	8	8		
62	Shndërrimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në Shoqëri Aksionare	5	2	7	7		
63	Shpallja I për Shndërrimin e Shoqërisë Aksionare	22	6	28	28		
64	Shpallja II për Shndërrimin e Shoqërisë Aksionare	11	-	11	11		
65	Shndërrimi i Shoqërisë Aksionare në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	8	-	8	8		
66	Projekt Bashkimi me Përthithje Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar	98	73	171	171		
67	Projekt Bashkimi me Përthithje Shoqërie Aksionare	6	4	10	10		
68	Projekt Bashkimi në Shoqëri të re me Përgjegjësi të Kufizuar	1		1	1		
69	Rezervim emri	189	1	190	190		
70	Printo Certifikatë	-	-	0	0		
71	Plotësim Ekstrakti Historik për Person Fizik	139	-	139	139		
72	Plotësim Ekstrakti Historik për Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar	26	-	26	26		
73	Projekt Ndarjeje në Shoqëri Ekzistuese për Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	1	-	1	1		
74	Projekt Ndarje në Shoqëri të re për Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	1	-	1	1		
75	Plotësim Ekstrakti Shoqëri Anonime	1	-	1	1		
76	Plotësim Ekstrakti Degë e Shoqërisë së Huaj	-	-	0	-		

77	Plotësim Ekstrakti Shoqëri Kolektive	-	-	0	-		
78	Plotësim Ekstrakti Shoqëri Kursim Krediti	-	-	0	-		
79	Bilanc vjetor	2089	23388	25477	25477		
80	Aplikim për pajisje me leje/licencë	261	6040	6301		6301	
81	Revokim vullnetar	117	265	382		382	
82	Ndryshim	1014	-	1014		1014	
83	Riprintim	-	-	0		-	
84	Shtyrje Afati	11	-	11		11	
85	Aplikim për ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	-	3365	3365			3590
86	Aplikim për regjistrim fillestar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	-	21240	21240			21499
	TOTALI	139196	116806	256002	248294	7708	25089

Shërbime ne sektorin e Trajtimit të të Dhënave dhe Korrespondencës	
Aktiviteti	Nr. Shërbimeve
Informacion dhe asistencë	43451
Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të mbërritura në rrugë elektronike	78324
Pajisja e subjekteve me kopje me origjinalin të dosjes elektronike	496
Dërgimin e çertifikatave të çregjistrimit te subjekteve	4123

Ndërkohë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, QKB-ja trajton kërkesa për informacion për të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në të tre regjistrat që administrohen nga QKB-ja, që vijnë nga Prokuroria, Gjykatat, ILDKPKI, KLGJ, KPK, Përmbarues, etj..

Të gjitha kërkesat e administruara nga QKB-ja gjatë vitit 2022 janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

2.4 Mbi trajtimin e ankesave

Gjatë vitit 2022 janë trajtuar mesatarisht 28 ankime administrative të përcjella në formë shkresore nga subjektet tregtare dhe 78 ankesa të përcjella nëpërmjet platformës “Bashkëqeverisje”.

2.5 Raportimi për International Co-operation Review Group (ICRG)’s Financial Action Task Force (FATF)

Gjatë vitit 2022 QKB-ja ka vijuar raportimin për International Co-operation Review Group (ICRG)’s Financial Action Task Force (FATF) për “Planin e Veprimit të ICRG/ FATF” dhe MONEYVAL për të përmbushur detyrat dhe rekomandimet e lëna për Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në zbatim të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2022 janë miratuar ndryshimet ligjore në kuadër të përmirësimit të mekanizmave për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të cituara më sipër. Nga Qendra Kombëtare e Biznesit është garantuar pjesëmarrja në çdo takim si online gjatë periudhës së COVID -19 dhe nga Maj 2022 pranë OECD në Paris.

2.6 Mbi angazhimin e QKB-së në kuadër të integritetit në BE

Gjatë vitit 2022 QKB-ja ka marrë pjesë në takimet e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës dhe takimet shpjeguese për Kapitullin 3, 6, 20, 23 dhe Kriterin Ekonomik. Në vijim të detyrave të përcjella nga ministria përgjegjëse, nga struktura përkatëse e institucioni janë përgatitur dhe plotësuar informacioni për guiding questions dhe prezantimet për takimet dypalëshe me shërbimet e BE për kapitullin 3, 6 dhe Kriterin Ekonomik. Është siguruar pjesëmarrja në takimet shpjeguese në Bruksel për Kapitullin 3, 6 dhe Kriterin Ekonomik.

2.7 Pjesëmarrje në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europianë]

Qendra Kombëtare e Biznesit, nëpërmjet përfaqësueve të saj nga struktura të ndryshme të institucionit, ka marrë pjesë në takime të organizuara nga EBRA në formën e takimit të Grupeve të Punës, duke synuar shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira në fushën e regjistrimit të biznesit dhe pronarëve përfitues.

2.8 Mbi proceset gjyqësore

QKB-ja gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 ka ndjekur me korrektësi dhe në zbatim të ligjit, të gjitha proceset gjyqësore, në të cilat QKB është palë në proces. Më konkretisht, Qendra Kombëtare e Biznesit ka qenë palë e paditur gjatë vitit 2022 në 46 procese gjyqësore dhe palë e tretë në 6 procese gjyqësore.

- Në 25 procese gjyqësore ku QKB-ja ka qenë palë e paditur është rrëzuar kërkesë padia;
- Në 1 proces gjyqësor ku QKB-ja ka qenë palë e paditur është pranuar kërkesë padia;
- Në 2 procese gjyqësor ku QKB-ja ka qenë palë e tretë është pranuar padia nga gjykata;
- Aktualisht në proces janë 20 procese gjyqësore ku QKB-ja është palë e paditur;

Aktualisht Qendra Kombëtare e Biznesit ka në proces si palë e tretë 4 procese gjyqësore. Ndërkohë, institucioni ynë ndjek me korrektësi dhe në zbatim të ligjit të gjitha proceset gjyqësore, në të cilat QKB-ja është palë në proces, të cilat janë procese gjyqësore të mbartura gjatë viteve.

2.9 Mbi menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimet e brendshme

Gjatë vitit 2022 nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimet e brendshme është kryer veprimtaria e mëposhtme:

Administrimi i dosjeve të personelit sipas legjislacionit të shërbimit civil. Plotësimi i librezave të punës, hedhja e të dhënave në Regjistrin e personelit (HRMIS) dhe Regjistrin Themeltar të personelit në kohë, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Përditësimi me të dhëna të plota të nëpunësve civil të QKB-së në HRMIS dhe raportimet mujore mbi lëvizjet, shkarkimet, performancat, proceset gjyqësore, ngritjet në detyrë në platform në administrata.al.

Planifikimi, menaxhimi dhe zbatimi i planit të rekrutimit, kryerja e procedurave të shpalljeve të pozicioneve vakante, analiza e krijimit të një pozicioni pune të ri etj. Gjithsej për vitin 2022 janë shpallur 7 pozicione vakante në shërbimin civil.

Ndjekja e procesit të vlerësimit periodik të punonjësve, sipas formatit me objektiva të përcaktuara në formularin tip në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndjekja dhe azhurnimi i çështjeve për deklarimin e pasurisë nga personat përgjegjës sipas legjislacionit përkatës.

Ndjekja dhe organizimi i programeve të trajnimit për nëpunësit e QKB dhe të sporteleve të shërbimit, si dhe hartimi i planit të trajnimeve dhe informimi mbi legjislacionin dhe standartet për etikën dhe transparencën në administratën publike.

Ristrukturimi i institucionit në kuadër të Urdhrit nr.80, datë 10.05.2022 “Për ndryshime në Urdhrin 136, datë 29.10.2020, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së QKB-së”. Ndryshimi dhe hartimi i përshkrimeve të punës në kuadër të ristrukturimit.

Hedhja e të dhënave të protokollit në regjistrat përkatës dhe në një databazë të posaçme elektronike. Në ditë protokollohen mesatarisht 300 shkresa hyrëse dhe 220 shkresa dalëse nga institucioni. Administrimi i praktikave të protokolluara sipas problematikës dhe periudhës së trajtimit.

Realizimi i dosjeve për DPA sipas kërkesave dhe rekomandimeve, duke dorëzuar vitet më të hershme 2009 dhe 2010.

Inventarizimi fizik i dokumentacionit në dosjet e subjekteve tregtare. Çdo ditë përpunohen mesatarisht 150 fletë në ditë.

Realizuar gjithsej 19 procedura prokurimi me blerje të vogla, për plotësimin e nevojave institucionale, në përputhje me regjistrin e parashikimeve për vitin 2022.

2.10 Pjesëmarrja në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtar të Europës Juglindore (BIFIDEX)

- Projekt i financuar nga BERZH.
- Ky Portal, përmes një platforme elektronike, synon t'i ofrojë publikut, të dhëna nga burimet zyrtare të të dhënave të regjistrave tregtar pjesëmarrës në këtë portal, duke integruar të gjithë komponentët e domosdoshëm të portalit me infrastrukturën e këtyre regjistrave, si dhe duke siguruar nivelin më të lartë të sigurisë.
- Fillimisht ky portal do të përmbajë funksione kërkimi për subjekte të regjistruar në regjistrat tregtar pjesëmarrës në këtë portal.
- Ndërkohë, në fazat e mëtejshme ky portal do të përmbajë edhe shërbime të tjera dhe opsione raportimi.
- Pra, me anë të këtij portali, do të mundësohet që çdo person i interesuar mund të informohet lidhur me procedurat e regjistrimit të biznesit në shtetet e Ballkanit Perëndimor, si dhe të kryejë kërkime për subjektet e regjistruar në regjistrat tregtarë të Ballkanit Perëndimor.
- Pjesëmarrja e regjistrat tregtar të administruar nga QKB është këshilluar edhe nga BB, Agjendën për Reformën e Investimeve Rajonale për Ballkanin Perëndimor (*Regional Investment Reform Agenda for the Eëstern Balkans*), për zbatimin e reformës “Përmirësimi i politikave dhe procedurave për themelimin e biznesit (*Improving business establishment policies and procedures*)”.

3. Analiza e realizimit të treguesve ekonomiko-financiar

Në zbatim të nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, QKB, ushtron aktivitetin buxhetor në programin buxhetor “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat e QKB, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, sipas programimit të bërë për vitin 2022.

Fondet buxhetore të ndryshuara për vitin 2022 për QKB në total janë 228 925 025 lekë prej të cilave 166 470 025 lekë janë shpenzimet korente, 60 655 000 lekë Grandi për NJQV-të dhe 1.800.000 lekë për shpenzime kapitale.

Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për 6-mujorin e parë të vitit 2022.

Tabela Nr.1. “Shpenzimet korente”

Llogaria	E M E R T I M I	Buxheti 12-mujori i vitit 2022			
		PLAN	FAKT	Diferenca	%
600	Pagat e punonjësve	64,203,850	64,177,652	26,198	100%
601	Kontributi i Sigurimeve shoqërore e shëndetsore	10,816,775	10,708,860	107,915	99%
602	Mallra e Shërbime	89,416,400	61,062,874	28,353,526	68%
604	Transferta të Brendshme	60,655,000	54,136,042	6,518,958	89%
605	Transferta me jashtë	775,000	744,600	30,400	96%
606	Transferta për buxhete familjare dhe individët	1,258,000	1,122,140	135,860	89%
I	SHPENZIME KORENTE GJITHSEJ	227,125,025	191,952,168	35,172,857	85%

Referuar Tabelës Nr.1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për vitin 2022 është në masën 85 %.

Më poshtë analizojmë faktorët që kanë ndikuar në këtë realizim:

Mosrealizimi vërehet kryesisht në zërin Shpenzime Operative ku buxheti 12 mujor prej 89 416 400 lekë, është realizuar në shumën 61 062 874 lekë ose në masën 68%.

Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqërore (zërat 600 + 601) janë realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar nga KM me Urdhër Nr. 136 datë 29.10.2020.

Realizimi për periudhën 12-mujore për art. 600 është 100% dhe art. 601 është 99% e buxhetit.

Tabela 2. Shpenzime Kapitale Në lekë

Llogaria	E M E R T I M I	Buxheti investime viti 2022			
		PLAN	FAKT	Diferenca	%
2310000	Rikonstrukcion rrjetesh uji, etj	85,000	84,017	983	99%
2318100	Pajisje zyre	600,000	432,000	168,000	72%
2318600	Pajisje kompjuterike	1,115,000	816,480	298,520	73%
II	SHPENZIME Kapitale	1,800,000	1,332,497	467,503	74%

Referuar Tabelës Nr.2 realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale për vitin 2022, është në masën 74%.

Për vitin 2022, QKB ka realizuar këto **të ardhura**, sipas **Tabelës Nr. 3:**

“Të ardhurat”

Llogaria	E M E R T I M I	Te ardhurat e vitit 2022			
		PLAN	FAKT	Diferenca	%
7,109,000	Të ardhura nga qeratë	106,000	53,795	52,205	51%
7,113,099	Të ardhura nga shërbimet	7,000,000	2,249,176	4,750,824	32%
7,115,655	Gjoha për deklarim të vonuar në RPP	7,500,000	43,101,500	-35,601,500	575%
7,115,499	Gjoha (kundravajtje administrative)	7,500,000	38,243,525	-30,743,525	510%
7,111,031	Të Ardhura nga BIFIDEX	0	457	-457	0%
7,190,990	Të tjera të ardhura jo tatimore	0	131	-131	0%
II	TE ARDHURAT	22,106,000	83,648,584	-61,541,996	378%

Këto të ardhura janë realizuar në masën 378% dhe janë derdhur 100% në buxhetin e Shtetit.

4. Objektivat për vitin 2023

Qendra Kombëtare e Biznesit me qëllim ushtrimin e kompetencave në përmbushje të misionit të

saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka hartuar dokumentin e objektivave për vitin 2023, ku janë përcaktuar objektivat e mëposhtme:

- Përmirësimi i sistemeve të Qendrës Kombëtare të Biznesit duke përfshirë të tre Regjistrat, faqen e ËEB-it;
- Rishikimi në tërësi i legjislacionit për regjistrimin e biznesit, licencimin/lejimin e biznesit;
- Ofrimi asistencës së vazhdueshme për subjektet përsa i përket procesit të regjistrimit të biznesit, licencimit/lejimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues;
- Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të subjekteve tregtare brenda afateve ligjore;
- Rritja e përqindjes së popullimit të Regjistratit të Pronarëve Përfitues me të dhënat e subjekteve raportuese të krijuara rishtazi dhe me të dhënat e përditësuara të subjekteve që kanë regjistruar më parë të dhënat;
- Shqyrtimi në përputhje me procedurën dhe afatet ligjore të gjitha aplikimeve të kryera për regjistrimin dhe licencimin e biznesit, si dhe regjistrimin e pronarëve përfitues;
- Zhvillimi i kapaciteteve të nëpunësve të QKB-së nëpërmjet programeve trajnuese;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së Portalit Rajonal të Regjistrave Tregtar të Europës Juglindore (BIFIDEX);
- Përmbushja e rekomandimeve të lëna nga MONEYVAL dhe raportim për progresin e raportin e ICRG/FATF për periudhën vijuese;
- Përafrimi i legjislacionit me acquis të BE;
- Mbulimi i veprimtarisë financiare të QKB-së, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për hartimin dhe zbatimin e buxhetit;